kushtet e domosdoshme nje mbledhja te mbahet pa u cenuar ne te gjithë formatin e saj duke i mundesuar qe aksionareve ti njihet e te ushtrojne te drejtat e tyre.

Mbledhjet e Asamblese Neni 19

Bordi drejtues ne perputhje me regjistrin e aksioneve, pregatit listen e pjesemarrësve ne asamblene e pergjithshme. Lista e cila firmoset nga kryetari i bordit e merr me vete dhe e paraqet ne vendin ku do te mbahet mbledhja. Ne liste duhet te percaktohen emer dhe mbiemer, emertimet, adresat e banimit, numri i aksioneve, aksione me perparësi, perqindja ne kapital, pjesemarrja personale apo me prokure si dhe vendi per te nenshkruar.

Bordi drejtues ben verifikimet e duhura per te hartuar listen e pjesemarrësve qofte nga regjistrat e shoqerise por edhe duke kontaktuar me aksionaret. Personat te cilet nuk kane emrin e tyre ne liste nuk mund te marrin pjese ne mbledhje. Lista e aksionare prezent ne mbledhje e cila firmoset prej tyre titullohet "Listprezence e aksionereve" dhe sic parashikohet edhe ne dispozita ligjore nese do te jete i pranishem ky procesvebal do te firmoset gjithashtu edhe nga perfaqësuesi ministror nga Drejtoria e Tregtise Rajonale.

Njoftimet Neni 25

Njoftimet e shoqerise do te behen jo me pak se 15 dite perpara ne nje gazete afer selise se saj ne perrcaktimet e dispozitave te paragrafit 4 te nenit 35 te Ligjit Tregtar Turk.

Njoftimet per mbledhjet e asamblese se pergjithshme behen ne perrcaktim te nenit 414 te Ligjit Tregtar Turk duke perjashtuar ditet e njoftimit dhe ditet e mbledhjes te pakten dy jave perpara.

Istanbul Memorial Saglik Yatirimlari Anonim Sirketi

Rregullorja e Brendshme mbi Parimet dhe Procedurat e Punes
se Asamblese se Pergjithshme te Shoqërisë

Kreu I Qellimi, Fusheprimi, Bazat dhe Perkufizimet

Neni 1 Qellimi dhe Fusheprimi

1) Qellimi i kesaj Rregullore te Brendshme eshte te percaktojë sakte kuadrin ligjor dhe perrcaktimet e statutit te shoqerise Istanbul Memorial Saglik Yatirimlari Anonim Sirketi per detyrat parimet dhe procedurat e Asamblese se Pergjithshme. Kjo rregullore permbledh te gjitha mbledhje e zakondshme dhe te jashtezakondshme te Istanbul Memorial Saglik Yatirimlari Anonim Sirketi.

Neni 2 Bazat

1) Kjo rregullore e brendshme eshte pergatitur nga bordi drejtues per te percaktuar detyrat dhe procedurat e asamblese te pergjithshme si dhe dispozitat ne lidhje me komisionarit perfaqësues te Ministrise se Tregtise dhe te Doganave.



Neni 3 Perkufizimet

- 1) Ne kete Rregullore te Brendshme kalojne perkufizimet si me poshte:
 - a) Permbledhje : Nje mbledhje ditore te Asamblese se Pergjithshme
 - b) Ligji : Ligjin Tregtar Turk nr 6102 dt 13/01/2011
 - c) Seanca : Cdo puntate e seciles seance e nderprere per arsye pushimi, per arsye te kohes se drekes apo per arsye te tjera te ngjashme
 - ç) Mbledhja : Mbledhjet e zakonshme dhe te jashtezakonshme te asamblese se pergjithshme
 - d) Komisioni i Mbledhjes : eshte komuniteti i perbere nga kryetari dhe nenkryetari i zgjedhur nga asambleja e pergjithshme per te drejtuar mbledhjen ne perputhje me ligjin nr419, neni I-re, paragrafi 4 , dhe ndihmesa te cilet mbajne procesverbalet dhe mbledhin votat sipas direktivave te kryetarit.

Kreu II Principet dhe Procedurat e Asamblese

Neni 4 Dispozitat qe do te zbatohen

1. Mbledhja do te behet ne perputhje me Ligjin ne fuqi dhe Statutin e shoqerise.

Neni 5 Pjesmarrja dhe Pergatitjet per ne Mbledhje

1. Ne mbledhje mund te marrin pjese aksioneret ose perfaqesuesit e tyre, anctaret e mbledhjes se Asamblese, auditues nese ka, perfaqesues nga Ministria nese eshte emeruar dhe punonjes te zgjedhur nga brodi drejtues per te kryer detyrat qe do i jepen gjate mbledhjes. Emrat e te gjitha pjesemarrësve jane te percaktuara ne listen e hartuar nga bordi drejtues. Nese shihet e pershtatshme hyrja ne mbledhje edhe te drejtuesve te tjere te shoqerise, punonjesve te teknikes se zerit dhe degjimit, vizitoreve apo edhe gazetarëve atehere kjo situatë do percaktohet ne rregulloren e brendshme.
2. Ne hyrje te vendit ku zhvillohet mbledhja ku jane vendosur aparaturat e kontrollit te kartave te identitetit dhe dokumentave te tjera bazuar ne ligjin 1527, aksioneret te cilet kane statusin person fizik bashke me perfaqesuesit qe jane emeruar per te perfaqesuar ne kete mbledhje, si dhe aksioneret te cilet kane statusin person juridik duhet te tregojne kartat e tyre te identifikimit, bashke me dokumenta e tjera qe vertetojne perfaqesimin e tyre ne kete mbledhje. Pas kesaj procedure duhet te firmosin ne listen e hartuar te pjesemarrësve. Kontrolli i dokumentave ne fjale behet nga nje ose me shume persona te emeruar nga bordi drejtues per te kryer kete procedure.
3. Bordi drejtues ben pergatitjet e nevojshme qe vendi i mbledhjes te mund te akomodoje te gjitha aksioneret si dhe cdo nevojë kancelarike apo aparature qe mund te duhet gjate mbledhjes. Te gjitha keto jane te percaktuara ne rregulloren e brendshme te shoqerise.

Neni 6

1. Mbledhja zhvillohet ne seline qendrore te shoqerise ose ne ndonje ambient tjetër ku e shihet e pershtatshme shoqeria per te cilen eshte bere njoftimi sipas afatit perkates, ne baze te nenit 416 te



Ligjit dhe konsiderohet e hapur pas verifikimit të bërë të procesverbalit të mbajtur nga kryetari ose nenkryetari ose njeri nga anëtarët e bordit drejtues në përputhje me nenin 418 dhe 421 të ligjit Tregtar Turk. (në rast të ndonjë dispozite të kundërt në Statutin e shoqërisë kjo situatë do të përcaktohet). Në këtë pikë zbatohen neni 20 dhe neni 22 i statutit të shoqërisë

Neni 7

Kryesia e mbledhjes

1. Në përputhje me aktin nr 6 të kesaj rregulloreje të brendshme, në drejtimin e një personi që hap mbledhjen nga kandidatët e propozuar zgjidhet një kryetar dhe nëse shihet e nevojshme edhe një nenkryetar i cili duhet të jetë nga aksionerët e shoqërisë.
2. Kryetari i mbledhjes mund të emerojë një person për të mbajtur procesverbalin dhe për të numëruar votat. (kur në Statutin e shoqërisë kjo parashikohet ndryshe atëherë kjo detyrë dhe detyra në lidhje me bërjen e të gjitha detyrave të aksionerit të vetëm të shoqërisë i cili njekohesisht është edhe kryetari i mbledhjes do të përcaktohen në rregulloren e brendshme. Gjithashtu në rregulloren e brendshme do të përcaktohet edhe rasti kur kryetari i mbledhjes do të ketë mundësinë për të emëruar një person teknik për sistemin e të gjitha veprimeve teknike që do nevojiten gjatë mbledhjes)
3. Kryesia e mbledhjes ka kompetencë për të fismosur procesverbalin e mbajtur si dhe të gjithë dokumentacionin tjetër që kanë qenë pjesë e mbledhjes.
4. Kryetari i mbledhjes gjatë kohës që drejton mbledhjen e asamblese vepron në bazë të legjislacionit në fuqi, Statutit dhe rregullores së brendshme të shoqërisë.

Neni 8

Detyrat dhe kompetencat e kryesise se mbledhjes

1. Kryesia e mbledhjes zotohet të përmbushë detyrat e mëposhtme :
 - a) Të shqyrtojë dhe kontrollojë nëse mbledhja do të zhvillohet në ambjentin ku u është bërë me dije me parë pjesëmarrësve. Nëse është përcaktuar vendi i mbledhjes në Statut, shqyrton nëse është i përshtatshëm ambjenti apo jo .
 - b) Shqyrton nëse lajmërimi për pjesëmarrje në mbledhje është bërë apo jo nëpërmjet shpalljes në fletoren zyrtare apo edhe në faqen e internetit për të cilën shoqëria është e detyruar të ketë adresën e saj të faqes së internetit dhe nëse ky lajmërim për mbledhje është bërë apo jo në afatin që parashikon ligji dhe rregullorja e shoqërisë, afat ky të paktën dy javë para nga data e mbledhjes. Të gjitha këto të dhëna është i detyruar të pasqyrojë në procesverbalin që mbahet gjatë mbledhjes.
 - c) Kontrollon personat të cilët nuk janë të autorizuar për të hyrë në mbledhje nëse kanë hyrë apo jo. Monitoron personat që u është dhënë detyra për të kontrolluar në hyrje në ambjentin të mbledhjes nëse janë duke e përmbushur detyrën e tyre në përputhje me nenin 5, paragrafi dytë të rregullores së brendshme të shoqërisë.
 - C) Në bazë të nenit 416 të ligjit tregtar turk, në rastin kur në mbledhjen e asamblese pjesëmarrësit janë mbledhur pa njoftimin e duhur, shqyrton nëse aksionerët apo përfaqësuesit e tyre janë gati apo jo për të zhvilluar këtë mbledhje, nëse ka kundërshtime



- apo jo per ta zhvilluar seancën e mbledhjes ne kete forme, gjithashtu kontrollon edhe nese pjesmarrja ne mbledhje e ruan kuorumin e pjesmarrjes se saj apo jo.
- d) Kontrollon dhe shqyrton te gjithë dokumentacionin ne rast se shoqeria ka pesuar ndryshime gjate kesaj kohe, nese keto ndryshime jane reflektuar ne dokumentat perkatese si ne rregjistrin e aksionereve, ne tabelat financiare, ne raportin vjetor te aktivitetit te shoqerise, ne raportin e auditit. Kontrollon nese keto ndryshime jane bere konform ligjeve ne fuqi dhe akteve te rregullores se brendshme te shoqerise gjithmone duke u marre lejet perkatese nga institucionet perkatese. Kontrollon procesverbalet e mbajtura ne rastet kur mbledhjet e asamblese se meparshme jane shtyre dhe pas shqyrtimit te te gjitha ketyre dokumentave ne lidhje me keto ceshtje, reflektohen ne procesverbalin perkates qe mbahet gjate mbledhjes.
 - e) Ben kontrollin e kartave te identifikimit ne raste edhe kur mund te kete ndonje kundërshtim nga pjesmarrësit ne mbledhje, dhe me pas firmos listen e pjesmarrësve qe jane gati per vazhdimin e mbledhjes.
 - f) Verifikon nese auditit te cilin e do shoqeri duhet ta kete, eshte gati apo jo ne mbledhjen qe do zhvillohet dhe kete situatë e pasqyron ne procesverbalin perkates qe mbahet gjate mbledhjes.
 - g) Menaxhon dhe drejton mbledhjen referuar rendit te dites, pengon qe gjate mbledhjes te flitet jashte ceshtjeve te rendit te dites, merr masat per ecurine sa me normale te mbledhjes.
 - h) Hap dhe mbyll seancat e mbledhjes si dhe perfundon mbledhjen.
 - i) Ne lidhje me ceshtjet e diskutuara ne mbledhje, lexon perpara te gjithë pjesmarrësve, te gjitha vendimet, draftet, procesverbalet, raportet, propozimet apo edhe sygjerimet qe jane marre gjate mbledhjes dhe u jep te drejten e fjales pjesmarrësve te cilet duan te diskutojne me teper rreth ketyre ceshtjeve.
 - j) Hedh ne vote vendimet qe merren nga ana e asamblese dhe jep rezultatin e votimit.
 - k) Kontrollon nese ruhet pjesmarrja/kuorumi ne mbledhje qe nga fillimi i saj e deri ne fund, si dhe kontrollon nese vendimet merren apo jo konform dispozitateve ligjore te Ligjit dhe akteve te Statutit te shoqerise.
 - l) I sqaron asamblese se pergjithshme te gjitha njoftimet e bera nga perfaqesuesit ne perputhje me nenin 428 te Ligjit Tregtar Turk dhe akteve te kontrates se shoqerise.
 - m) Kontrollon nese kane votuar apo jo personat te cilet sipas nenit 436 te Ligjit nuk kane te drejte vote per vendimet qe merren ne kete mbledhje.
 - n) Nese shihet e arsyeshme te shtyje per ne takimet e radhes vendimet qe duhet te marri asambleja e pergjithshme ne lidhje me negociimin e tabelave financiare per 1 te 10 e kapitalit dhe ceshtje te tjera qe lidhen me kete teme te cilat do te behen gjithmone me kerkese te aksionereve.
 - o) Te mundesoje hartimin e procesverbaleve ne lidhje me ceshtjet e trajtuara ne mbledhje, te pasqyroje ne procesverbal te gjitha propozimet dhe kundërshtimet, te firmose vendimet dhe procesverbalet dhe te pasqyroje ne procesverbal pa asnje ndikim votat ne favor apo ne disfavor te dhena nga votuesit per vendimet qe jane marre.



- p) Procesverbali i mbajtur gjate mbledhjes, raporti vjetor i aktivitetit, raporti i auditit, tabelat financiare, listat me emrat e pjesmarresve ne mbledhje, kartoni i votes nese ka dhe cdo dokument tjetër ne lidhje me mbledhjen i dorezohen me ane te nje procesverbali njerit nga anetareve te bordit drejtues.

Neni 9

Veprimet qe duhen bera para se te kalohet ne rendin e dites se mbledhjes.

1. Kryetari i mbledhjes i lexon asamblese rendin e dites. Kryetari pyet nese do te kete apo jo ndonje propozim per ndryshim ne lidhje me nenet e rendit te dites. Nese do te kete ndonje propozim per ndryshim i paraqitet per miratim asamblese. Nese miratohet me shumice votash atehere behet ndryshimi i neneve te rendit te dites gjate diskutimit.

Neni 10

Tematikat e Rendit te Dites

1. Ne rendit e dites se mbledhjes se zakonshme te Asamblese duhet te jene pjese tematikat e meposhtme :

- a) Hapja e mbledhjes dhe krijimi i komisionit te mbledhjes.
- b) Diskutimet rreth raportit vjetor te aktivitetit te shoqerise, raportit te auditit dhe tabelave financiare.
- c) Lirimin e anetareve te bordit drejtues dhe te auditit nese ka.
- ç) Zgjedhja e anetareve te bordit drejtues dhe te auditit nese i ka mbaruar mandati.
- d) Percaktimi i te drejtave te pages shtese per anetaret e bordit drejtues si shperblimet apo primet.
- e) Percaktimi i menyres se perdorimit te fitimit, shperndarjes dhe percaktimi i normes se pjeseve te fitimit.
- f) Negociata rreth ndryshimeve ne statusin e shoqerise gjithmone nese ka ndryshime .
- g) Tema te tjera te nevojshme.

2. Ka arsye qe bejne te detyrueshme nje mbledhje te jashtezakonshme te Asamblese.

3. Ceshtjet qe nuk jane pjese e rendit te dites nuk diskutohen dhe per to nuk merren vendime.

Pervec rasteve perjashtuese te meposhtme;

- a) Kur aksioneret jane prezent te gjithë ne mbledhje dhe me unanim votash mund te shtojne ne rendin e dites edhe ceshtje te tjera te propozuara.
- b) Kur ndonjeri prej aksionereve paraqet kerkesen e tij per auditim ne perputhje me nenin 438 te ligjit Tregtar Turk. Kjo vendoset me vendimin qe do te marre bordi drejtues i asamblese pa e marre parasysh nese kjo ceshtje eshte perfshire apo jo ne axhenden e dites.
- c) Kriteret per heqjen nga detyra dhe emerimeve te reja te anetareve te bordit drejtues, konsiderohen te jene te lidhura me nenin negociues te pasqyrave financiare te fundvitit dhe duke u biseduar vendoset nese do te kete nje nen apo jo per kete ceshtje ne axhenden ditore.



- d) Edhe sikur të mos ketë një nen në axhendën ditore, ceshtjet për heqjen nga detyra dhe e emërimeve të reja të anëtarëve të bordit drejtues si pasoje e arsyeve të justifikueshme si papajtueshmëria, apo veshtiresitë në kryerjen e detyrës, fenomen i cili është i pranishëm në shumë shoqëri, me shumicën e votave të pjesëmarrësve në asamblenë e përgjithshme këto tematike do të behen pjesë e axhendes ditore.

4. Për ceshtjen e rendit të ditës për të cilën pasi është diskutuar në mbledhjen e asamblese pritet të merret një vendim dhe me unanim votash nuk jepet një vendim rreth tij, atëherë për të nuk do të ketë një vendim të dytë.

5. Temat për të cilat për një arsye cilado qofte kërkohen nga Ministria për tu diskutuar në mbledhjen e asamblese se shoqërise do të behen pjesë e axhendes ditore.

6. Axhenda përcaktohet nga personi që lajmëron për zhvillimin e mbledhjen se asamblese.

Neni 11

Marrja e fjalës në mbledhje

1. Nëse aksionerët apo pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje kërkojnë të marrin fjalën për tematikën që është duke u diskutuar e kërkojnë këtë nga kryesia. Komisioni i bën me dije asamblese personat të cilët kanë kërkuar fjalën dhe u jepet e drejta e fjalës sipas radhës që ato kanë aplikuar. Nëse personi i cili ka kërkuar fjalën dhe gjatë kohës që i është dhënë koha për të folur nuk ndodhet në sallë, e humb të drejtën e fjalës. Personat midis tyre mund ta ndryshojnë radhën e marrjes së fjalës. Nëse personi ka marrë fjalën dhe është duke diskutuar rreth temës, nëse koha që ka në dispozicion mbaron, ai mund ta vazhdojë diskutimin duke marrë kohë nga koha e personit pasardhës i cili ka radhën për të folur, vetëm nëse ky i fundit pranon. Në mënyrë tjetër koha për të folur nuk mund të zgjatet .

2. Anëtarëve të bordit drejtues të cilët kërkojnë të japin mendimet e tyre rreth temave të diskutuara, mund t'u jepet e drejta e fjalës pa respektuar radhën.

3. Kohezgjatja për të marrë fjalën për diskutim vendoset nga asambleja e përgjithshme në bazë të numrit të pjesëmarrësve në mbledhje, sasise dhe rëndësise së ceshtjeve që do të trajtohen në mbledhje. Në rastë të tillë si fillim asambleja vendos nëse është e nevojshme apo jo të vendoset një kufi kohë për diskutim dhe pastaj me votim vendoset se cili do të jetë edhe limiti i kohës.

4. Në rast kur pjesëmarrja e aksionerëve apo e përfaqësuesve të tyre në mbledhje bëhet nga ambiente elektronike në përputhje me nenin 1527 të ligjit tregtar turk, për marrjen e propozimeve apo të mendimeve të tyre do të zbatohet kriteret e përcaktuara më poshtë.

Neni 12

Votimi dhe mënyra e përdorimit të votes

1. Para se të fillojë procesi i votimit, kryetari i mbledhjes i bën me dije asamblese ceshtjen për të cilën do të votohet. Nëse do të votohet për draftin e një vendimi, më përpara lexohet në prani të të gjithëve dhe pastaj kalohet për votim. Pasi hidhet në votim, mund të kërkohet fjala për diskutim vetëm nëse do të flitet rreth ceshtjes e cila është hedhur në votim. Gjatë kesaj kohe nëse ka ndonjë nga aksionerët i cili ka kërkuar të drejtën e fjalës dhe nuk i është dhënë, i rikujton komisionit



kerkesen e tij dhe pasi miratohet nga komisioni perdor te drejten e fjales. Nuk jepet e drejta e fjales pasi ceshtja ka kaluar ne votim.

2. Votat ne lidhje me ceshtjet e diskutuara ne mbledhje mund te jene te tipit duke ngritur doren ose duke u cuar ne kembe ose duke thene me goje pro ose kundra. Votat numerohen nga kryesia e mbledhjes. Nese do te jete e nevojshme kryetari i mbledhjes emerone persona te tjere per te ndihmuar ne numerimin e votave. Pjesmarresit te cilet nuk kane kryer aktin e votimit duke ngritur doren, duke u ngritur ne kembe apo duke u shprehur pro ose kunder, do te quhet se ka dhene vote refuzuese dhe ne vleresimin e votave do te konsiderohet qe ka votuar ne disfavor te vendimit.

3. Per perdorimin e votes se aksionereve apo te perfaqesuesve te tyre te cilet marrin pjese ne mbledhjen e asamblese nepermjet ambjenteve elektronike referuar nenit 1527 te Ligjit, do te zbatohen nenet dhe dispozitat e ligjit perkates per kete tematike.

Neni 13

Hartimi i procesverbalit te mbledhjes

1. Komisioni i mbledhjes firmos listen e pjesmarresve qe jane gati per mbledhje, ne te cilen jane pasqyruar aksioneret ose perfaqesuesit e tyre bashke me aksionet, llojin, numrin dhe vleren nominale te cilet ato disponojne. Mundeson perpelimin e procesverbalit konform rregullave dhe ligjeve ne fuqi duke pasqyruar ne menyre sa me transparente votat pro dhe kunder ne lidhje me cdo vendim per te cilin eshte votuar pa anashkaluar te pasqyroje edhe cdo pyetje dhe pergjigje e dhene ne mbledhjen e asamblese.

2. Procesverbali i mbledhjes se asamblese mbahet ne vendin ku zhvillohet mbledhja dhe shkruhet ose ne kompjuter ose me stilolap me shkrim dore qe te jete i kuptueshem per tu lexuar. Eshte kusht qe ne ambjentet e mbledhjes gjate kohes qe procesverbali pergatitet ne kompjuter, per ta printuar duhet te kete edhe nje aparat printimi.

3. Procesverbali mbahet te pakten ne dy kopje dhe firmoset ne cdo faqe nga komisioni i mbledhjes dhe perfaqesuesi i Ministrise kur eshte prezent ne mbledhje.

4. Ne procesverbal duhet percaktuar emertimi tregtar i shoqerise, data dhe vendi i mbledhjes, sasia e aksioneve dhe vlera nominale e aksioneve te shoqerise, shuma totale e aksioneve te perfaqesuara, emri mbiemri i perfaqesuesit te Ministrise, nese ka, bashke me daten dhe nr e protokollit te shkreses qe e autorizon ate si perfaqesues ne kete mbledhje, ne cfare menyre eshte bere ftesa nese njoftimi per mbledhje eshte bere nepermjet shpalljes dhe nese mbledhja behet pa njoftuar kjo gjithashtu duhet cikluar ne procesverbal.

5. Numri i votave ne lidhje me vendimet qe jane marre gjate mbledhjes, pa asnje dyshim me te vogel do te tregohen ne procesverbal me numer dhe me shkrim.

6. Personat te cilet kane votuar kunder nje vendimi te marre ne mbledhje dhe kerkojne qe kjo te reflektohet ne procesverbal, u shkruhet emri, mbiemri dhe arsyeja e votes kunder.



7. Ne rast se arsyeja e votimit kunder jepet me shkrim atehere kjo shkrese i bashkangjitet procesverbalit si shtojce e saj. Ne procesverbal shkruhet emri mbiemri i aksionerit ose i perfaqesuesit i cili eshte ne statusin e opozitarit dhe theksohet se shkresa e votimit kunder eshte pjese shtojce e ketij procesverbali. Kjo shkrese firmoset nga komisioni i mbledhjes dhe nga perfaqesuesi i Ministrise nese do te kete .

Neni 14

Procedura qe do te ndiqet ne fund te mbledhjes

1. Kryetari i mbledhjes ne fund te mbledhjes nje kopje te procesverbalit bashke me dokumentat e tjera plotesuese ja dorezon njerit prej anetareve te bordit drejtues, pjesmarres ne mbledhje. Dorezimi behet duke mbajtur nje procesverbal ndermjet paleve.
2. Bordi drejtues eshte i detyruar ta noterizoje procesverbalin prane nje noteri te licensuar brenda 15 diteve nga data e mbledhjes dhe nje kopje te noterizuar te saj ta dorezoje prane qendres se regjistrimit tregtar dhe te beje te mundur regjistrimin e tyre si dhe shpalljen ne fletoren zyrtare.
3. Procesverbal mund te vendoset edhe ne faqen zyrtare te internetit te shoqerise nese shoqeria e ka detyrim te hapi nje faqe interneti, brenda 5 diteve nga data e mbledhjes se asamblese.
4. Kryetari i mbledhjes nje kopje te listes se pjesmarresve, te axhendes dhe te procesverbalit te mbledhjes se asamblese ja dorezon perfaqesuesit te Ministrise.

Neni 15

Pjesmarrja ne menyre elektronike ne mbledhje

1. Per pjesmarrjen ne menyre elektronike ne mbledhjen e asamblese, pjesmarrje te cilen e parashikon edhe neni 1527 i Ligjit, do te zbatohen perkatesisht neni 1527 i Ligjit dhe dispozitat perkatese.

Kreu III

Dispozita te ndryshme

Neni 16

Pjesmarrja e perfaqesuesit te Ministrise dhe dokumentat ne lidhje me mbedhjen e asamblese

1. Per mbledhjet ne te cilat eshte e detyrueshme pjesemarrja e perfaqesuesit nga Ministria, aktet rregullatore ne lidhje me pjesmarrjen ne mbledhje te perfaqesuesit te Ministrise se Tregtise dhe Doganave bashke me kriteret dhe parimet e mbledhjes se asamblese se shoqerive anonime ne lidhje me kopencat dhe detyrat e ketyre perfaqesuesve jane konfidenciale.
2. Per pergatitjen e listes se pjesemarrresve dhe te atyre qe jane prezent ne mbledhje te asamblese dhe per perpilimin e prokurave qe do te perdoren si dokument vertetues per pjesmarrjen ne mbledhje bashke me hartimin e procesverbalit, duhet te zbatohen dispozitat e rregullores te percaktuara ne paragrafin e pare te saj.

Neni 17

Situata te paparashikuara ne rregulloren e brendshme

1. Ne mbledhjet e asamblese, per raste te cilat nuk jane te parashikuara ne rregulloren e brendshme te shoqerise, do te veprohet sipas vendimeve qe do te marri bordi drejtues.



Neni 18

Pranimi dhe ndryshimet e rregullores së brendshme

1. Kjo rregullore e brendshme e shoqërisë Anonime “ By Mobitech Elektronik Sanayi “ miratohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe legjimitohet nga bordi drejtues, rregjistrohet ne organet perkatese dhe shpallet ne Fletoren Zyrtare. Ndryshimet qe do te behen ne kete rregullore do ti nenshtrohen te njejta kriterëve.

Neni 19

Hyrja ne fuqi e rregullores

1.Kjo rregullore e shoqërisë anonime “ Istanbul Memorial Saglik Yatirimlari Anonim Sirketi “ miratohet ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme me date 16.04.2013 dhe hyn ne fuqi me shpalljen ne fletoren zyrtare te Regjistrimit Tregtar Turk.

Turgut Aydin	13175954948	Kryetar Bordi	(firme)
Ahmet Yasar Aydin	55729009018	Zv.kryetar Bordi	(firme)
Ayhan Aydin	13169955166	Anetar	(firme)
Ali Riza Artunkal	37081627420	Anetar	(firme)
Schminur Aydin	55726009172	Anetar	(firme)
Ihab Ghasoub Jamil Asali	0860455937	Anetar	(firme)

Komisionari ministror Omer Kurtlar (firme)

(5/A)(29/232825)

Ky Dokument eshte i
Njehsur me Origjinalin

22 Dhjetor 2023

Dhoma e Tregtise Stamboll
Ahmet Simsek
Zv. Sekretar i Pergjithshme
(vule, firme)

---APOSTILLE---

(Konventa e Hagës, datë 5 Tetor 1961)

- 1- Shteti **TURQI**
Ky dokument zyrtar:
- 2- Eshtë nënshkruar nga: **Ahmet Simsek**
- 3- Titulli i nënshkruesit: **I Autorizuar**
- 4- Mbart vulën e: **Dhoma e Tregtise Stamboll**

---VERTETIM---

- Kjo çertifikatë lëshohet
- 5- në Prefekturën e Uskudar
 - 6- më 22.12.2023
 - 7- nga: **Suleyman Gurbey – Dr. protokoll**
 - 8- Nr. **55870**
 - 9- Vula
 - 10- Nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ELONA A. SYLA



V2023052500299485985



DATE 28/12/2023
NR REP 6168

VERTETIM

Vertetoj firmën e përkthyesit *Ahmet Gjinishi* i njohur nga unë e nr NIPT i L29108101T, i cili deklaron dhe firmos në praninë time, se përkthimi i dokumentit nga gjuha turke në gjuhën shqipe është plotësisht konform dokumentit të bashkëngjitur, prandaj unë noteri e nënshkruaj atë.